



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA E URBANISTIKËS**

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë"; E-mail: bashkiavlore@yahoo.com

**RELACION ARKITEKTONIK:**

**PROJEKTI : TROTUAR DHE HAPESIRE REKREATIVE NË RRUGEN  
"FEJZO GJOMEMA", VLORE.**

# I-PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

## 1.1 Pozicioni dhe qëllimi i i projektit arkitektonik




Projekti i propozuar konsiston ndërhyrje urbane në infrastrukturën, në veri të segmentit rrugor “Fejzo Gjomemo”. Qëllimi i projektit është ndryshimi i sheshit pranë stacionit të autobusit duke krijuar një hapësirë rekreative e cila me ngjyra dhe dinamizem vizual optik ndryshon situatën aktuale të zonës e cila funksionon si parkim. Këto elemente arkitektonike të shoqërua me mobilim urban si stola , gjelberim dhe ndrimim të ri për sheshin i japin aktivitet një zonë jo pak të rëndësishme , referuar rëndësisë së fluksit të banorëve dhe turistëve që përkrahin atë trotuar. Ngjyrat përcillen dhe harmonizohen edhe në vijëzime rrugore dhe sinjalistikën e taksive dhe autobuzave.

Ndërhyrja tjetër e këtij segmenti ndërtimi i korsisë së bicikletave. Kjo korsia propozohet të realizohet duke ngushtuar brezin aktual të gjelber në 50-60 cm dhe zgjerim në pjesën aktuale të trotuarit ekzistues. Brezi i gjelber do të përkrahë total trotuarin si një barier mbrojtëse nga makinat, gjerësia e brezit varion 220-250 cm. Bimësia dhe pemët aktuale nuk do të ndryshojnë në . Korsia e bicikletës do të jetë e gjerë 120 cm. Gjelberimi, korsia e bicikletës dhe trotuari do të jenë në të njëjten kuotë, kjo estetizohet dhe funksionalisht korrekt normativave të projektimit. Detajet e shtresave të korsisë së bicikletës dhe trotuarit paraqiten në projektin arkitektonik të detajuar.

Korsia e bicikletës ka një gjatësi rreth 330 m. Ajo përfundon në fund të segmentit me qëllim që në të ardhmen të bashkohet me fazën e dytë të ndërhyrjeve në trotuaret e rrugës Transballkanike.

Aktualisht ky segment trotuari është i mbuluar me 4 tipologji të ndryshme pllake betoni. Propozohet unifikimi i saj me pllake guri, detajet teknike paraqiten në projektin arkitektonik.


Projekti nuk cënon ndricimin dhe bimësin ekzistuese në kufij me rrugën. Projekti ka për qëllim rritjen e cilësisë së estetike pasi është një trotuar shumë i populluar për faktin e pozicionimit lidhur me rrethrotullimet kryesor të qytetit dhe objekteve me rëndësi që ka përball.





Hapësirën rekreative do të mobilohet me detaje urbane:



- Stola te dy dimensioneve të ndryshme (skicat teknike në projekt)
- Ndricules shtylla
- Bariera mbrojtëse
- Kosha të vegjel për mbeturina
- Gjelbërimi pemë Blin dhe lule dekorative të ulëta shumëngjyrëshe.

Prerje Terthore i Trotuarit



- Shtrese me pllaka Guri, t=6cm
- Llac cemento C70
- Shtrese betoni ekzistues
- Tokë natyrë





## Projektoi :

Ark.Erisa.Muka Lic.A.2106

**DREJTOR**

Ingli Xhaferaj